



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 39 dhe nenin 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/24)

1. Në Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të regjistrit të kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 186/13, 74/15 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 146/20), pika 12-a ndryshon dhe bëhet:

"12-a. Çdo person fizik ka të drejtë qasjeje në të dhënat personale të tyre nga Regjistri i Kredive për periudhën e fundit raportuese.

Për marrjen e të dhënave nga paragrafi (1) i kësaj pike, personi fizik paraqet kërkesë në Bankën Popullore.

Kërkesa paraqitet personalisht nga personi fizik, përmes përfaqësuesit të autorizuar ose në formë elektronike me përdorimin e veglës së identifikimit elektronik përmes Portalit Kombëtar të shërbimeve elektronike, në pajtim me rregulloret në fushën e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike.

Formulari i kërkesës, kur kërkesa nga paragrafi (3) i kësaj pike është dërguar personalisht nga personi fizik, dhe formulari i autorizimit mund të merret në Bankën Popullore ose shkarkohet nga faqja e internetit e Bankës Popullore dhe jepen në shtojcat 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Formulari i kërkesës, kur kërkesa nga paragrafi (3) i kësaj pike dërgohet në formë elektronike me përdorimin e veglës së identifikimit elektronik nëpërmjet Portalit Kombëtar të shërbimeve elektronike, është i disponueshëm në formatin elektronik në www.uslugi.gov.mk."

2. Në pikën 12-b), në paragrafin (1) në fjalinë e parë, fjalët: "i dhënë në shtojcën 3 të këtij vendimi dhe fjalja e dytë, fshihen.

Paragrafi (2) ndryshon dhe bëhet: "Raporti nga Regjistri i Kredive (shtojca 3) në rast se kërkesa paraqitet personalisht nga personi fizik dhe/ose nga përfaqësuesi i autorizuar, i lëshohet personalisht personit fizik ose përfaqësuesit nga pika 12-a), paragrafi (3) i këtij vendimi, identiteti i të cilit konfirmohet duke treguar dokument

identifikimi të vlefshëm (letërnjoftimi/pasaportë). Për mbrojtjen e të dhënave personale, Raporti nga Regjistri i Kredive jepet në zarf të mbyllur, të vulosur dhe të mbrojtur në pajtim me rregulloret e punës në zyrë dhe punës arkivore. Raporti përgatitet jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga dita e pranimi të kërkesës.”

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3): “Raporti me të dhënat nga Regjistri i Kredive, në rast se kërkesa paraqitet në formë elektronike duke përdorur vegël të identifikimit elektronik nëpërmjet Portalit Kombëtar të shërbimeve elektronike, është në dispozicion të parashtruesit të kërkesës në formë elektronike.”

3. “SHTOJCA 3”, zëvendësohet me “SHTOJCË 3” të re,

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-7700/7
28 shkurt 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

SHTOJCA 3



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

SEKRET PROFESIONAL
Drejtoria për Mbikëqyrje nga Jashtë dhe Licencimin

Shkup, _____

Nr.

Drejtuar

Lënda: Dërgimi i të dhënave

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën tuaj për marrjen e të dhënave nga Regjistri i Kredive, ju njoftojmë se në Regjistrin e Kredive, të cilin Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ka themeluar dhe menaxhuar në pajtim me nenin 39 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21), për ju përpunohen të dhënat në vijim:

1. Emri dhe mbiemri
2. Numri i vetëm amë
3. Ekspozimi në banka/kursimore
4. Kërkesat e fshira nga bilanci i shënimeve në banka/kursimore
5. Garanton në banka/kursimore
6. Data e fundit e të dhënave personale të raportuara

Bankat dhe kursimoret dërgojnë të dhëna dhe informacione në Bankën Popullore për mbajtjen e Regjistrit të Kredive. Përdorues të Regjistrit të Kredive janë Banka Popullore dhe bankat dhe kursimoret që kanë marrë licencë për themelim dhe punë nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore.

Në pajtim me Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 186/13, 74/15, 77/15 dhe 146/20), bankat janë të detyruara të dërgojnë të dhëna për bankat vendase dhe të huaja, jorezidentët, institucionet financiare jobankare vendase, personat e tjerë juridik jofinanciar vendas me ekspozim total ndaj rrezikut kreditor mbi 300 mijë denarë, si dhe për persona fizik vendas dhe shitësit me pakicë me ekspozim total ndaj rrezikut kreditor mbi 5 mijë denarë.

Kursimoret janë të detyruara të dërgojnë të dhëna të veçanta për të gjitha personat juridikë me ekspozim total ndaj rrezikut kreditor mbi 50,000 denarë dhe për të gjithë personat fizik dhe shitësit me pakicë me ekspozim total ndaj rrezikut kreditor që tejkalon 5,000 denarë.

Banka Popullore përdor të dhënat nga Regjistri i Kredive si pjesë e zbatimit të funksionit të saj mbikëqyrës, për qëllime të analizimit të rrezikut të kredisë ndaj të cilit janë të ekspozuara bankat dhe kursimoret gjatë punës së tyre. Bankat dhe kursimoret përdorin të dhënat nga Regjistri i Kredive si ndihmë në vlerësimin e aftësisë kreditore të çdo klienti të ri ose ekzistues.

Shënim: Të dhënat e përfshira në Regjistrin e Kredive nuk mund të jenë baza e vetme për marrjen e vendimit të gjykatës ose ndonjë vendimi tjetër që shkakton pasojë juridike mbi atë person ose që e prek ndjeshëm atë. Në rast se të dhënat janë të gabuara, duhet të kontaktoni bankën/kursimoren që ka dërguar të dhënat e gabuara dhe e cila duhet të bëjë ndryshimet e duhura, në pajtim me Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive.

Përpiloi:

Drejtori: